

VivaPrime



ASTARI



Astar akrilik me bazë uji për aplikim me rulon dhe shpatull.

- Redukton ngjitjen e cepave
- E përshtatshme për rinovime dhe shtrime nga e para
- Raport i mirë kosto/performancë
- Përpunimi i shpejtë dhe i sigurt

Gama e përdorimit:

Të përshtatshme për lloje druri evropian me ngjyrë të hapur si p.sh. lisi, ahu, plepi, frashëri, bredhi me ngjyrë të çelët. Në rast dyshimi konsultohuni me fabrikën. Reduktim i ngjitjes së cepave shkaktuar nga bojërat e ujit.



Të dhëna teknike të produkteve

NR. ARTIKULLI			
11518	5l	4	128
	10l	-	60

Solide	29 ±2%
Viskoziteti	20 ±2s
Magazinimi dhe transportimi	12 muaj kohëzgjatja maksimale e magazinimit. Material i parrezikshëm sipas ADR. Depozitim dhe transportim në temperatura +5°C deri +25°C. Mbrojeni nga ngrica.
GISCODE	W2+
2004/42/CE	Vlera e lejueshme i BE-së për produktin (Kat. A/i): 140g/l (2010). Ky produkt përmban maksimumi 49g/l VOC.

Udhëzime përpunimi

- Sipërfaqja duhet të jetë lëmuar siç duhet. Dyshemeja duhet të jetë e thatë, pa shtresa të vjetra, vaj, yndyra, dyll, silikon, pluhur lëmimi dhe papastërti të tjera.
- Kushtet optimale të përpunimit eksitojnë në një temperaturë mjedisi nga +15°C deri + 25°C, temperaturë dyshemeje +15°C deri +22°C, lagështirë relative të ajrit 40% - 75%, temperaturë të materialit +18°C - + 25°C, lagështirë maksimale të drurit 12%, ajrosini mjaftueshëm mjediset e punës.
- Për të parandaluar dëmtimet e parketit duhet që gjatë përpunimit të synohet klima e pritshme e mjedisit që pritet në mesin e vitit.
- Për të reduktuar rrezikun e presionit të tepërt të ënjtjes, rekomandojmë aplikimin e maksimumit 2 aplikime me rul në ditë.
- Para aplikimit transferoni materialin në një kovë LOBATOOL.
- Përzieri mirë materialin.
- Kini parasysh rregullat e përgjithshme dhe specifike të sigurisë së punës për produktin. Me shumë informacion specifik në lidhje me GISCODE mund të gjendet tek udhëzimet e përdorimit, të disponueshme në www.wingis-online.de.

HOLLUES

Produkti është gati për përpunim dhe nuk lejohet hollimi!

MJET APLIKIMI / NORMË APLIKIMI

LOBA rul boje universal 100 ose LOBA rul boje me mikrofibra 100-120 / 100-120 ml/m²

Shpatull LOBA / afro 60ml/m² (16m²/l) (2 x me lëvizje në kryq).

RRASHINIM I NDËRMJETËM

Astari nuk ka nevojë për rrashinim të ndërmjetëm.

KOHA E THARJES

- Aplikimi me rulon të dorës së dytë verniku jo më shpejt se 60 minuta, me shpatull jo më shpejt se 30 minuta, por gjithsesi brenda 24 orëve.
- Në rast vonese në tharje, prisni deri sa të thahet plotësisht.

PËR LYERJEN MBI BOJËRA TË PËRSHTATSHME:

Konsum normal:

- Life.

Deri konsum i fortë:

- Viva.
- EasyFinish.

Deri në konsum tepër të fortë:

- 2K Fusion.
- 2K Duo.
- 2K Supra A.T..
- 2K UltraSport.

PËRDORIMI:

- Përgatitje e përshtatshme e nënshtresës.
- Aplikoni me rulon një shtresë të trashë astari.
- Tharje.
- Aplikoni me rulon vernik uji LOBA.

APLIKIMI ALTERNATIV ME SHPATULL:

- Përdoreni vetëm mbi ah, frashër. Përdorni vetëm rulon për dysheme të vjetra të dëmtuara dhe dysheme me fuga.
- Përgatiteni siç duhet dyshemenë
 - me shpatullën VivaPrime (rreth 40 ml/m²).
 - Tharje.
 - Bëjeni shtrimin në kryq (rreth 20 ml/m²)
 - Tharja rreth 30 minuta.
 - Aplikoni me rulon vernik uji LOBA.

Udhëzime të përgjithshme

Pastrimi i mjeteve të punës: Pastroni mjetet e punës me ujë menjëherë pas përdorimit.

Koha e tharjes: Koha e tharjes e përmëndur është e vlefshme për temperaturë +20°C dhe lagështi relative të ajrit 50%, si dhe ajrosje të vazhdueshme të ambientit të punës, pa rryma ajri. Temperaturat më të ulta, lagështia relative e lartë, mosajrosja e duhur vonojnë tharjen. Pa arritur forcimin (tharjen) e plotë mos pastroni dhe mos shtroni tapete. Për mbulimin e sipërfaqes para tharjes së plotë përdorni LOBA Cover 400. Karakteristikat specifike të produktit gjenden në informacionet teknike përkatëse.

Përdorim i astarit apo punim vetëm me vernik: Përdorimi i astarit rrit sigurinë e përpunimit dhe garanton një sipërfaqe pa shenja dhe vijëzime, pothuajse në çdo rast pavarësisht llojit të drurit. Më shumë detaje gjenden në listën me llojet e drurit LOBA të katalogu në fjalë.

Ngjitje e anëve: Sistemet e bojrave me bazë ujin në përgjithësi kanë tendencë për ngjitje të cepave. Për të reduktuar formimin e lidhjeve të parregullta dhe ngjitjen e mëvonshme të elementeve këshillohet marrja e masave paraprake si: ngjitje e qëndrueshme elastike ose kundër shtytëse e elementeve të parketit, mbushje të kujdeshme e fugave me stuko, përdorim i astarëve të përshtatshëm si p.sh. LOBA EasyPrime, trajtimi paraprak i anëve të zbrazta të parketeve prej druri solid me dyll të përputhshëm me bojën, para instalimit. Po ashtu, marrja e masave të cilat do ruajnë një klimë të qëndrueshme në dhomë dhe veçanërisht lagështinë relative të ajrit. (Rekomandohet informimi me kujdes i klientit). Veçanërisht të ndjeshme janë dyshemetë e vjetra të dëmtuara ose të paqëndrueshme, parketet prej druri me ngjitje elastike ose të gozhuara, parketet me dërrasa druri, dyshemetë me veshje druri, parketet laminate, parketet mbi dysheme me system ngrohje, drurët me kohë të shkurtër ndryshimi të lagështirës si ahuj, panja.

Ndërveprime: Materiale të tilla si p.sh. nënshtresat e tapeteve, këmbët dhe rrotat e mobiljeve, ngjitësat elastikë për ngjitje ose fiksime të parketeve mund të shkaktojnë zbutje dhe çngjyrosje. Materiale ndërtimi të lëna mbi lidhjet mund të ndikojnë negativisht në prekje dhe në pamje. Ekspozimi në bojra floku, goma makinash, motorash, biçikletash, gjithashtu mund të shkaktojnë çngjyrosje të përhershme dhe të pandryshueshme të sipërfaqes.

Informacioni në këtë material si dhe të gjitha këshillat dhe rekomandimet, të cilat ofrojmë në ndihmë dhe asistencë të përdoruesit, janë rezultat i përvojës së deritanishme dhe u referohen kushteve Speciale. Për shkak të mundësive të shumta të aplikimit dhe kushteve të përpunimit, nuk përjashtojmë nevojën e përdoruesit për të kryer testimet e veta ose të kërkojë këshilla teknike duke kontaktuar me Departamentin e aplikimit teknik LOBA. Respektoni standartet aktuale dhe rekomandimet e prodhuesit të produkteve për shtrimin-përpunimin e parketeve. Detyrimet dhe përgjegjësia janë përcaktuar ekskluzivisht nga Termat dhe Kushtet tona dhe nuk zgjerohen as përmes këtij informacioni as përmes këshillave tona. Publikimi i të dhënave më të reja teknike automatikisht zhvlerëson ato të mëparshme.

Fjalët dhe simbolet me shenjën ® përfaqësojnë të drejta tregu, të cilat janë të regjistruara dhe të mbrojtura të paktën për hapësirën e Gjermanisë.